



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 176 Akti**

**Nr. 152 Vendimi**

**Tiranë, më 07.06.2019**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Roland Ilia**

**Kryesues**

**Valbona Sanxhaktari**

**Anëtare**

**Xhensila Pine**

**Relatore**

në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, asistuar nga sekretare gjyqësore, Olsida Goxhaj, më datë 6 qershor 2019, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** Z. Edvin Kondili, prokuror në Prokurorinë pranë

Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

**OBJEKTI:**

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:**

Neni 179/b i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tria kriteret e vlerësimit, atë të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

## V Ë R E N:

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Edvin Kondili, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Edvin Kondili, është shortuar me shortin e hedhur, në datën 17.9.2018, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”. Në referim të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për të ka filluar menjëherë pasi është shpërndarë me short çështja konkrete.
3. Në mbledhjen e trupit gjykues, në datën 03.10.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjykues, komisioner Roland Ilija. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Edvin Kondili.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
5. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016; ku ka konstatuar:
  - *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
  - *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
  - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
  - *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
  - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
6. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 dhe në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, e ka dërguar një raport, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Edvin Kondili*.
7. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale gjatë periudhës objekti i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016.
8. Në vijim, nga ana e Komisionit janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke u kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm.
9. Trupi gjykues, në datën 24.05.2019, në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Edvin Kondili dhe njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes së hetimit administrativ te kryer nga Komisioni, dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
10. Subjekti i rivlerësimit z. Edvin Kondili në datën 24.05.2019 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni.
11. Subjekti i rivlerësimit z. Edvin Kondili u njoh me materialet e dosjes së hetimit administrativ te kryer nga Komisioni dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së shpjegimeve të tij në datën 27.05.2019.

**12.** Trupi gjykues në prani të vëzhgueses ndërkombëtare pasi analizoi shpjegimet e sjella nga subjekti i rivlerësimit, z. Edvin Kondili vendosi në datën 29.05.2019 t'i dërgojë atij rezultate shtesë të hetimit administrativ.

**13.** Subjekti i rivlerësimit në datën 03.06.2019, z. Edvin Kondili paraqiti shpjegime mbi rezultatet shtesë të hetimit administrativ.

**14.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**15.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Edvin Kondili u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 6.6.2019, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

**16.** Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**17.** Subjekti i rivlerësimit, z. Edvin Kondili, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit z. Edvin Kondili ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**18.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues, që mbështetet në Aneksin e Kushtetutës, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si dhe në ligjin nr. 84/2016.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**19.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” si dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI;
- b) Deklaratat vjetore të pasurisë si dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI;
- c) Raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- d) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- e) Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) Shpjegimet me shkrim dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit.

**20.** Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Edvin Kondili, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e

krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklaram të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen. Pas hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, rezulton si vijon:

**21. Apartament 2+1, me sip. 86.7 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë.** Vlera e apartamentit 70.000 euro. Burimi i krijimit (kredi 60.000 euro në “Raiffeisen Bank” + kursime familjare). Kontratë blerjeje nr. \*\*\*, dt 18.10.2011, me firmën “\*\*\*\*”. Pjesa takuese: 50 %.

**Faktet nga hetimi administrativ:**

**22.** ZVRPP-ja Tiranë me shkresën nr. \*\*\*, datë 19.10.2018, informon se në emër të shtetasve Edvin Kondili dhe bashkëshortes së tij M.K., rezulton pasuri në bashkëpronësinë, nr. pasurisë \*\*\*, z.k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, lloji i pasurisë “apartament” me sip. 86.6 m<sup>2</sup>.

**23.** Në kartelën e pasurisë me nr. \*\*\* seksioni hipotekës ka shënimin bankar: Bllokohet në favor të “Raiffeisen Bank” për shumën 60.000 euro.

**24.** Referuar kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 18.10.2011, pala shitëse shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. i shet palës blerëse Edvin Kondili dhe M.K., apartamentin me sip. 86.6 m<sup>2</sup>, kundrejt shumës 70.000 euro.

**25.** “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2018, konfirmon se znj. M.K., ka marrë kredi në shumën 60.000 euro me qëllim blerje shtëpie.

**26.** Disbursimi në llogarinë bankare nr. \*\*\* në emër të znj. M.K., në shumën 60,000 euro me përshkrim “Disbursim kredie, pagesë për blerje apartamenti” ka kaluar në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**27.** Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. me e-mail-in e datës 25.4.2019, dërgoi mandatpagesën nr. \*\*\*, datë 18.10.2011, për pagesën e këstit të parë prej 10.000 eurosh (dhjetë mijë euro), dhe konfirmoi se pjesa tjetër e pagesës është bërë nëpërmjet xhimit të bankës prej 60.000 euro (gjashtëdhjetë mijë euro).

**28.** Subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2011 ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në vlerën 1,600, 000 lekë, për pagesën e shumës 10,000 euro për blerjen e apartamentit dhe për komisione e primin e sigurimit për lëvrimin e kredisë

**29.** Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit z. Edvin Kondili dhe bashkeshortja e tij kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti.

Nr.	Përshkrimi	Viti 2011
<b>Nr.</b>	<b>Pasuritë</b>	<b>9,364,699</b>
1	Apartament, sip. 86.7 m <sup>2</sup> , Rr. “****”, Tiranë	9,681,000
2	Pakësuar likuiditetet	-316,301
	<b>Të ardhurat</b>	<b>2,292,767</b>
<b>1</b>	Paga e subjektit	1,524,726
<b>2</b>	Paga e bashkëshortes së subjektit	735,641
<b>3</b>	Honorare të bashkëshortes Universiteti “****” (banke)	32,400
	<b>Detyrimet</b>	<b>8,298,249</b>

1	Kredi në "Raiffeisen Bank" për blerje apartamenti	8,298,000
2	Shlyerje e kësteve të kredisë	-49,751
	<b>Shlyerja e kësteve të kredisë në euro</b>	360
	<b>Shpenzime</b>	<b>1,136,360</b>
1	Pagese e kopshtit të djalit në kopshtin "****"	240,000
2	Komisione për lëvrimin e kredisë	200,000
3	Paguar interesa në "Credins Bank"	54,000
4	Paguar interesa në "Raiffeisen Bank"	22,500
5	Për aredimin e shtëpisë	210,000
6	Shpenzime jetike sipas ILDKPKI	409,860
	<b>DIFERENCA</b>	<b>39,957</b>

30. Me rezultatet shtesë të hetimit administrativ, ju kerkuan shpjegime per burimin e ligjshem te depozitimeve cash, te bera nga subjekti në llogarinë e bashkeshortes tuaj:

- Viti 2012 4,300 Euro
- Viti 2013 2.900 Euro
- Viti 2014 2.200 Euro
- Viti 2016 1,000 Euro

31. Subjekti i rivleresimit shpjegoi se këto shuma, janë depozitime me qëllim pagimin e kësteve mujore të pagesave të kredisë të marrë, për qëllim blerjen e apartamentit në vitin 2011. Burimi vjetor i këtyre shumave, janë të ardhurat nga pagat. Sqaroj se me raste, në funksion të depozitimit të një shume ka përdorur edhe pjesë nga gjendja e shumave kesh në disponimin tonë. Përgjithësisht, ky veprim është bërë ose në periudha në fillim të vitit ose me qëllim për të patur gjendje në bankë një shumë korrespondente me 3 apo 4 këste mujore, për të mos shkuar në bankë çdo muaj. Pagesa e kësteve të kredisë së apartamentit që prej fillimit e në vazhdim është një shpenzim që mbulohet nga të ardhurat vjetore nga pagat, e imja dhe e bashkeshortes.

32. Nga hetimi administrativ ka rezultuar në llogarinë bankare të znj. M.K. një transferte në mbërritje nga E.B., (bashkëshortja e vëllait) në shumën 10,000 euro.

33. Pas pyetjes nga Komisioni në datën 02.10.2014 z. Edvin Kondili ka shpjeguar se kjo shumë ishte marrë me qëllim shlyerjen e një pjese të kredisë për blerjen e apartamentit, pasi interesat vjetore, ishin të larta, por pas tërheqjes ai e bashkeshortja kishin vendosur kthimin e saj duke ja dorëzuar në shtator 2016 znj. P.A., mamasë së huadhënësit.

34. Subjekti i rivlerësimit z. Edvin Kondili ka depozituar dokumentacionin ligjor provues, mbi të ardhurat e realizuara ndër vite të shtetasit B.A., në formën e kërkuar nga ligji.

35. Shuma 10,000 euro është tërhequr *cash* në vitin 2015 nga bashkëshortja e subjektit. Referuar deklaramentit periodik të vitit 2015 nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar gjendje *cash* në shtëpi, në fund të këtij viti ne deklarimin periodik vjetor.

36. Me rezultatet e hetimit të datës 24.05.2019 subjektit të rivlerësimit z. Edvin Kondili, iu kerkuan të japë shpjegime për këtë mosdeklarim.

- 37.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit z. Edvin Kondili sqaroi se këtë shumë, është deklaruar nga ai në momentin e marrjes në vitin 2014, edhe në momentin e kthimit të saj, të papërdorur, në vitin 2016, në deklaratat periodike, të 2014 dhe 2016, edhe në “Vetting”.
- 38.** Ai shpjegoi se kjo shumë është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2015, në rubrikën “ e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, në faqen nr. 5 të deklaratës, por nuk është deklaruar në rubrikën “ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, në faqen nr. 3 të kësaj deklarate, vetëm për shkak të perceptimit që kjo shumë monetare lidhej me huan/detyrimin dhe jo me gjendjen e krijuar për shkak kursimi.
- 39.** Me rezultate shtese te hetimit administrativ u kerkua te shpjegohej burimi i të ardhurash financimi për të paguar borxhin.
- 40.** Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se kjo shumë prej 10.000 euro, u mor nga unë dhe bashkëshortja në muajin tetor 2014, me qëllim për të shlyer, një pjesë të kredisë prej 60.000 euro të marrë nga në vitin 2011, për blerjen e apartamentit, me qëllim ulje të shumës tërësore të saj (60.000-10.000), përpara afatit 30 vjeçar të maturimit të saj e si ka shpjeguar në vijimësi se lidhur me këtë qëllim, kjo hua nuk u përdor.
- 41.** Por, për shkak të qënies së saj, gjendje në bankë për lehtësi veprimi, për të mos shkuar në bankë, shlyerja e kësteve mujore të kredisë së apartamentit, bëhej nga kjo shumë (deri në muajin korrik 2015) Në të njëjtin moment, në çdo fillim muaji e njëjta vlerë e këstit mujor, që tërhiqej nga banka, mbahej në banesë nga pagat, me qëllim për të mos e cënuar shumën e marrë hua, në tërësinë e saj prej 10.000 euro, në funksion kjo, që te përdorej për qëllimin për të cilin e kishin marrë. Në muajin korrik të vitit 2015, kjo shumë prej 10.000 euro përbëhej nga një shumë prej rreth 7000 euro gjendje në bankë dhe rreth 3000 euro të grumbulluara në banesë. Kjo shumë e tërhequr dhe e mbajtur në vazhdim në gjendje kesh është burimi për shlyerjen e huasë prej 10.000 euro në muajin shtator 2016.
- 42.** Trupi gjykues nga analiza e shpjegimeve dhe dokumentacionit provues mbi të ardhurat e vëllait të bashkëshortes së subjektit, z. B.A.Xh., arrin në përfundimin se, huadhenesi ka pasur të ardhura të ligjshme, për të dhënë hua shumën 10.000 euro.
- 43.** Trupi gjykues arrin në përfundimin se shuma prej 10.000 eurosh e cila rezulton të këtë qenë gjendje *cash* në fund të vitit 2015, nuk është deklaruar në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2015 si gjendje *cash*.
- 44.** Komisioni me rezultatet e hetimit shtesë në datën 29.5.2019 i kërkoi subjektit te rivlerësimit shpjegime për transferta nga vëllai i bashkëshortes së subjektit, znj. M.K.  
- 5.955.35 euro, më datë 14.07.2015;  
- 500 euro, më datë 13.11.2015;  
- 466 euro, më datë 08.07.2017.
- 45.** Në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit z. Edvin Kondili shpjegoi se per tranferten e datës 14.07.2015, vëllai i bashkëshortes u ka kërkuar, që për arsye të ngutshme personale-familjare, t’i jepnim, prindërve të dhe bashkëshortes një shumë monetare prej 5,955 eurosh. Nga ana e tij dhe e bashkëshortes, u është dhënë prindërve ( të bashkëshortes) kjo shumë, nga gjendja *cash* që dispononin, e brenda pak ditësh u është bërë kompensimi i kësaj shume, nëpërmjet transfertës së bërë nga shtetasja E.B, bashkeshortja e vëllait) në llogarinë e bashkëshortes së tij, znj. M.K.
- 46.** Në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit z. Edvin Kondili shpjegoi se per transfertat 500 euro, më datë 13.11.2015 dhe 466 euro, më datë 8.7.2017, ju është kërkuar blerja e dy pajisjeve shtëpiake për llogari të prindërve të cilat janë blerë me të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes dhe pas pak ditësh është bërë kompensimi i kësaj shume, nëpërmjet transfertës së bërë në llogarinë e bashkeshortes znj. M.K.

47. Në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit deklaroi se në fund të viteve 2015 dhe 2016, nuk janë deklaruar këto veprime, sepse nuk kanë qenë as dhurim dhe as hua dhe nuk kanë sjellë rritje apo ulje në pasurinë e tij dhe të bashkëshortes.

48. **Automjet, tip “Mercedes Benz”**, targë \*\*\*, në vlerën 500.000 lekë. Burimi i krijimit kursimet nga pagat. Kontratë blerje \*\*\*, datë 01.08.2015. Pjesa takuese: 50 %.

#### Faktet nga hetimi administrativ

49. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2018, konfirmon se subjekti i rivlerësimit, z. Edvin Kondili, ka të regjistruar mjetin me targë \*\*\*.

50. Automjeti tip “DAIMLER” E 270 CDI, është blerë me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, nga pala shitëse R.P., në vlerën 500.000 lekë.

51. Me kontratën e shkëmbimit nr. \*\*\*, datë 08.07.2017, subjekti i rivlerësimit ka shkëmbyer automjetin, tip “DAIMLER” E 270 CDI, me targë \*\*\*, viti i prodhimit 2004, me automjetin, tip “DAIMLER” E 280 CDI, me targë \*\*\*, viti i prodhimit 2007 me shtetasin E.L., duke paguar ketij te fundit dhe shumë prej 420.000 lekë.

52. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni sipas tabelës rezulton se subjekti i rivlerësimit ka të ardhura të ligjshme për blerjen e mjetit të mësipërm.

Nr.	Përshkrimi	2,015
Nr.	Pasuritë	<b>515,646</b>
1	Automjet "Mercedes Benz" targa ***,	500,000
2	Shtesë likuiditetesh	15,646
	<b>Të ardhurat</b>	<b>3,051,211</b>
1	Paga e subjektit	1,715,773
2	Paga e bashkëshortes së subjektit	721,519
3	Nga shitja e automjetit	137,650
4	Nga prindërit për pagesat për shkollën e djalit, kolegji "****"	476,269
	<b>Detyrimet</b>	<b>-552,272</b>
13	Shlyerje e kësteve të kredisë	-552,272
	Shlyerja e kësteve të kredisë në euro	4,037
	<b>Shpenzime</b>	<b>1,613,064</b>
5	Paguar interesa në “Credins Bank”	54,000
8	Pagesa për shkollën e djalit, kolegji "****"	476,269
9	Për aredimin e shtëpisë sipas përgjigjeve të pyetësorit, datë 19.2.2019	50,000
10	Udhëtime jashtë vendit (TIMS)	371,655
11	Shpenzime jetike sipas ILDKPKI	661,140
	<b>DIFERENCA</b>	<b>370,229</b>

**53. Kursime nga pagat në “Raiffeisen Bank” me nr. \*\*\*, në llogari të znj. M.K. Vlera 1.280.597,09 lekë.**

**54.** “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2018, konfirmon llogarinë e pagës në emër të znj. M.K., me balancë 1.280.597 lekë dhe overdraftin e lidhur me llogarinë me limit 50.000 lekë.

**55.** Në “Raiffeisen Bank” në llogarinë me nr. \*\*\*, të znj. M.K. gjendja në datën 25.1.2017 rezulton në shumën 1.280.597,09 lekë dhe overdraft në shumën 50.000 lekë. Nga analiza financiare e kryer rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj llogarie.

**56.** Depozitë në “Credins Bankën”, me nr. llogarie \*\*\*, në emër të djalit të subjektit E.K., nga kursimet familjare. Vlera 86.365,08 lekë.

**57.** Depozitë në “Credins Bankën”, me nr. llogarie \*\*\*, në emër të djalit të subjektit E.K., nga kursimet familjare. Vlera 86.365,08 lekë.

**58.** “Credins Bank” me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.12.2018, konfirmon depozitën e mësipërme. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni vihet re se subjekti i rivlerësimit ka të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj depozite.

**59.** Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë të ardhura të ligjshme për krijimin e depozitave të mësipërme.

**60. Kursime në gjendje cash (nga pagat si dhe nga një shume prej 1.100.000 lekësh sjellë nga bashkëshortja në momentin e martesës në vitin 2007), në shumën prej 1.400.000 lekësh.** Shuma prej 1.100.000 lekësh e sjellë nga bashkëshortja është krijuar para martesës (në vitin 2007) prej pagës së saj. Vlera 1.400.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

**61.** Në deklaratën e interesave private periodike/vjetore të vitit 2007, subjekti ka deklaruar gjendje cash nga bashkëshortja para martesës në vlerën prej 1.100.000 lekësh. Subjekti deri në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2006 ka qenë me status civil beqar. Nga analiza financiare rezulton se në periudhën 2003–2006 ka krijuar të ardhura në vlerën prej 1.058.422 lekësh.

**62.** Subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e pyetësorit në datën 18 shkurt sqaron se: “Shuma prej 1.100.000 lekësh është krijuar para martesës nga bashkëshortja, si rezultat i bashkimit të kursimeve nga paga e saj si e punësuar prej vitit 2003 si dhe nga shuma që i është dhuruar nga familja e saj (vëllai z.B.A.).

**63.** Z. Edvin Kondili depozitoi vërtetimin e të ardhurave nga shoqata “\*\*\*\*”, si dhe dokumentacionin provues të të ardhurave të shtetasit B.A.Xh., vëllai i bashkëshortes.

**64.** Në analizën financiare për krijimin e kësaj shume nga bashkëshortja janë marrë në konsideratë të ardhurat e krijuara nga bashkëshortja deri në mars të vitit 2007, kohë kur janë martuar.

**65.** Instituti i Sigurimeve Shoqërore me shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2019, informon se znj. M.K., ka qenë e punësuar dhe ka derdhur kontributin e sigurimeve shoqërore për periudhën 2003–2009. Paga mbi të cilën është llogaritur kontributi i sigurimeve shoqërore për periudhën 2003–2006 është në vlerën prej 1.310.787 lekësh.

**Të dhëna të tjera gjatë hetimit administrativ:**



66. Në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2006 subjekti i rivlerësimit deklaroi marrjen e një kredie konsumatore të “Raiffeisen Bank” në vlerën 450.000 lekë për të ndihmuar të afërmin e tij, z. E.H. **Sipas shkresës së “Raiffeisen Bank”** kjo kredi paguhet nga subjekti i rivlerësimit, z. Edvin Kondili.

67. Me pyetësorin e datës 19 shkurt 2019, z. Edvin Kondili, deklaroi se: “Z. E.H. është mik i imi (shok i ngushtë që nga fëmijëria). Për shlyerjen e kredisë, si të kësteve mujore përkatëse ka financuar z. E.H., i cili ishte përfituesi i saj”.

68. Nga informacioni i marrën nga “Raiffeisen Bank” rezultoi se z. Edvin Kondili ka lidhur kontratë kredie bankare në datën 13.9.2006 për marrjen e kredisë në shumën 450,000 lekë me një afat 60 muaj me qëllim përdorimin e tyre për nevoja personale.

69. Deklarimet e subjektit ngelen vetëm deklarative pasi nuk ka asnjë dokumentacion ligjor dhe financiar për të provuar sa ai deklaroi trupi gjykues vendosi që të konsiderojë se kredia është marrë dhe shlyer nga vetë subjekti i rivlerësimit.

#### 70. Analiza financiare për vitin 2006

Nr.	Përshkrimi	Viti 2006
<b>Nr.</b>	<b>Pasuritë</b>	<b>361,173</b>
	<b>Shtesë likuiditetet</b>	361,173
	<b>Të ardhurat</b>	1,107,820
	<b>Paga e subjektit</b>	1,107,820
	<b>Paga e bashkëshortes së subjektit</b>	
	Detyrimet	366,447
	Shlyerjeje kredi konsumatore	
	Shlyerjeje kredi konsumatore	-36,053
	Kredi konsumatore të “Raiffeisen Bank”	650,000
	Shlyer këst kredie në “Raiffeisen Bank”	-150,000
	Shlyer këst kredie në “Raiffeisen Bank”	-63,000
	Shlyer këste të borxhit	-34,500
	<b>Shpenzime</b>	<b>124,074</b>
2	Interesat e kësteve të kredisë në “ProCredit”	2,147
10	Udhëtime jashtë vendit (TIMS)	12,370
11	Shpenzime jetike sipas ILDKPKI	109,557
	<b>DIFERENCA ( B-A-C-D)</b>	<b>989,020</b>

71. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka të ardhura të ligjshme për shlyerjen e kesaj kredie.

72. Në deklaratën e interesave private periodike/vjetore të vitit 2008 subjekti i rivlerësimit deklaroi automjet tip “Mercedes Benz” të përgjithshëm pasi nuk është bërë zhdoganimi. Ky automjet blerë në datën 29.2.2008, në vlerën 100,000 lekë dhe 500.000 lekë janë kryer riparime.

73. Në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2008 subjekti i rivlerësimit deklaroi automjet, tip “Mercedes Benz” të përgjithshëm pasi nuk është bërë zhdoganimi. Sipas deklaratave të subjektit ky automjet është blerë në datën 29.2.2008 në vlerën 100,000 lekë dhe 500.000 lekë janë kryer riparime.

74. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2015 deklaroi shitjen e këtij automjeti në vlerën 1,000 euro. Në përgjigje të pyetësoreve subjekti deklaroi: “Ky automjet është blerë në gjendje absolutisht të parregullt teknike. Është bërë gjatë vitit 2008, një riparim i tij në shumën prej 500.000 lekësh. Edhe pas këtyre shpenzimeve, ky automjet nuk u bë asnjëherë funksional dhe në vitin 2015 është shitur-dorëzuar për pjesë këmbimi”.

75. Me përgjigjet e pyetësorit protokolluar me nr. \*\*\* prot, datë 26.02.2019, në Komisionin subjekti depozitoi një kopje të kontratës së shitblerjes me nr. \*\*\*, datë 29.02.2008, si dhe një kopje të deklaratës së datës 01.08.2015 për shitblerje automjeti.

#### 76. Analiza financiare për vitin 2008

Nr.	Përshkrimi	Viti 2008
	<b>Pasuritë</b>	<b>598,812</b>
	Automjet, tip “Benz Mercedes”, viti 2000	600,000
	Pakësuar likuiditetet	-1,188
	<b>Të ardhurat</b>	<b>1,842,451</b>
	Paga e subjektit	1,279,962
	Paga e bashkëshortes së subjektit	461,239
	Leja e lindjes bashkëshortes	62,370
	Lektor në Shkollën e Magjistraturës	38,880
	<b>Detyrimet</b>	<b>325,919</b>
	Kredi konsumatore të “Raiffeisen Bank”	885,152
	Shlyer këst kredie në “Raiffeisen Bank”	-522,033
	Shlyer këst kredie në “Raiffeisen Bank”, viti 2008	-37,200
	<b>Shpenzime</b>	<b>862,644</b>
	Për arredimin e shtëpisë sipas pyetësorit, datë 19.2.2019	200,000
	Udhëtime jashtë vendit (TIMS)	140,428
	Shpenzime jetike sipas ILDKPKI	522,216
	<b>DIFERENCA ( B-A-C-D)</b>	<b>706,914</b>

77. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezulton se subjekti i rivlerësimit ka të ardhura të ligjshme për blerjen e mjetit të mësipërm.

78. Në llogarinë bankare nr. \*\*\* në emër të znj. M.K., për shlyerjen e kësteve të kredisë janë derdhur cash nga subjekti shumë akumulative si më poshtë:

- viti 2012 shuma e akumuluar 2,970 euro (me katër transaksione);
- viti 2013 shuma e akumuluar 3,900 euro (me katër transaksione);
- viti 2014 shuma e akumuluar 3,300 euro (me pesë transaksione);
- viti 2016 shuma e akumuluar 2,000 euro (me dy transaksione).

**79.** Me rezultatet e hetimit shtesë në datën 29.5.2019 i është kërkuar subjektit të shpjegoj burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre depozitimeve *cash* të bëra gjatë viteve.

**80.** Në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit subjekti deklaroi se këto shuma, janë depozitime me qëllim pagimin e kësteve mujore të pagesave të kredisë të marrë nga bashkëshortja e tij në “Raiffeisen Bank” me qëllim blerjen e apartamentit në vitin 2011. Burimi i këtyre shumave të depozituara janë të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes.

**81.** Në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit subjekti deklaroi se: me raste, në funksion të depozitimit të një shume kanë përdorur edhe pjesë nga gjendja e shumave *cash* që dispononin. Përgjithësisht, ky veprim është bërë ose në periudha në fillim të vitit ose me qëllim për të pasur gjendje në bankë një shumë korrespondente me 3 apo 4 këste mujore, për të mos shkuar në bankë çdo muaj. Në të gjitha rastet, vlerën korrespondente të përdorur nga shumat *cash* më pas e kanë zëvendësuar, nga të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes, në periudha të mëpasshme, gjithmonë, brenda vitit.

**82.** Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të kryer depozitimet në llogarinë e kredisë.

**83.** Prindërit e subjektit V., dhe L.K., kanë kryer e pagesat të kopshtit “\*\*\*\*” për vitin 2012, 2013 në shumën 440.000 lekë, si dhe të shkollës “\*\*\*\*” për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, në shumën 12.770 euro, për djalin e subjektit, E.K.

**84.** Në zbatim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “*Persona të tjerë të lidhur janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose cdo mardhënie tjetër biznesi*”, prindërit e subjektit të rivlerësimit u konsideruan perona të lidhur.

**85.** Komisioni kreu hetim të thelluar administrativ mbi mundësitë financiare të prindërve për pagesat e kryera për djalin e subjektit dhe vlerësoi se të ardhurat e realizuara ndër vite nga L., dhe V.K., janë të mjaftueshme për të kontribuar në pagesat e këtyre faturave.

**86.** Nga verifikimi i llogarive bankare në emër të L., dhe V.K., rezulton se vetëm nëpërmjet “BKT”-së janë likuiduar detyrimet për kopshtin “\*\*\*\*” nga L.K., si më poshtë:

- në vitin 2012 ka kryer 3 pagesa në shumat 44.000 lekë secila, në total 132.000 lekë;
- në vitin 2013 ka kryer 2 pagesa në shumat 44.000 lekë secila, në total 88.000 lekë.

**87. Analiza financiare për personat e tjerë të lidhur e gjendjen e llogarive bankare**

Gjendja e llogarive bankare te personave te lidhur	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
<b>TOTALI</b>	1,415,714	1,640,101	1,944,137	2,133,696	2,246,208	2,406,375	2,473,875	2,493,845
<b>Shtesa/Pakësime</b>	(1,406,267)	224,387	304,036	189,559	112,512	160,168	67,500	19,970

## Të ardhurat

V., dhe L.K.,									
V.K.,	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
Widom shpk (pedagoge)		172,138	697,287	429,909	458,958	582,160	282,252	445,666	499,585
Shkolla e Magjistratures						111,041	63,000	162,729	
UET nga Banka Credins						129,975			
Universiteti Luarasi nga B. Credins						106,900	335,033	272,847	118,105
Pension V.K.,					272,880	272,880	272,880	272,880	272,880
Paga kalimtare mujore	76,500								
L.K., pension fillon 01.09.2008	76,120	228,360	228,360	228,360	228,360	228,360	228,360	228,360	228,360
<b>TOTALU</b>	<b>152,620</b>	<b>400,498</b>	<b>925,647</b>	<b>658,269</b>	<b>960,198</b>	<b>1,431,316</b>	<b>1,181,525</b>	<b>1,382,482</b>	<b>1,118,930</b>

## Pagesat për kopshtin dhe shkollën e djalit të subjektit nga prindërit e tij

Nr.	Përshkrimi	2,012	2,013	2,014	2,015	2,016
1	Pagese e kopshtit të djalit në kolegjin "****"	264,000	176,000	0	0	0
2	Pagesa për shkollën e djalit në kolegjin "****"	0	329,494	484,781	476,269	473,445
	Pagesa për shkollën e djalit "****" në euro					
	<b>TOTALI i pagesave të kryera nga prindërit</b>	<b>264,000</b>	<b>505,494</b>	<b>484,781</b>	<b>476,269</b>	<b>473,445</b>

**88.** Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezulton se të ardhurat e realizuara ndër vite nga shtetasit L., dhe V.K., janë të mjaftueshme për të kontribuar në pagesat e faturave për shkollimin e djalit të subjektit.

## Analiza financiare përmbledhëse për subjektin e rivlerësimit

**89.** Nga analiza e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit, bazuar në gjendjet e likuiditeteve, në të ardhurat e ligjshme, në shpenzimet detyrimet financiare, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, krahasuar ato me informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore, për periudhën e rivlerësimit 2004–2016, në tabelën më poshtë, nuk rezulton që subjekti të ketë pasur likuiditete të pajustificuara.

Viti	Të ardhura	Pasuritë	Detyrime	Shpenzime	Diferenca
2004	537,186	0	198,034	122,034	<b>613,186</b>
2005	1,056,784	15,748	175,719	144,576	<b>1,072,179</b>
2006	1,107,820	361,173	366,447	124,074	<b>989,020</b>

2007	2,720,836	1,049,352	-222,000	478,698	<b>970,786</b>
2008	1,842,451	598,812	325,919	862,644	<b>706,914</b>
2009	2,060,067	-85,574	-920,000	821,796	<b>403,844</b>
2010	1,766,474	-85,008	0	984,885	<b>866,597</b>
2011	2,292,767	9,364,699	8,248,249	1,136,360	<b>39,957</b>
2012	2,455,320	538,163	-603,000	1,031,832	<b>282,325</b>
2013	2,602,467	474,543	-603,000	1,412,987	<b>111,937</b>
2014	2,770,300	1,804,226	798,100	1,390,031	<b>374,143</b>
2015	3,051,211	515,646	-552,272	1,613,064	<b>370,229</b>
2016	2,771,288	-1,033,733	-1,953,372	1,501,498	<b>350,152</b>
<b>TOTALI</b>	<b>27,034,971</b>	<b>12,918,047</b>	<b>5,258,824</b>	<b>11,624,479</b>	<b>7,151,270</b>

**90.** Nga analiza financiare ndër vite rezulton se subjektii rivlerësimi ka pasur mjete monetare të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e kryera. Pasaktësia e konstatuar nuk krijon dyshime të arsyeshme për veprime që cenojnë figurën e prokurorit.

#### **Konkluzion përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë**

**91.** Komisioni vlerëson se subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

**92.** Komisioni vlerëson se pasaktësia e konstatuar për mosdeklarimin në vitin 2015 të shumës *cash*, prej 10.000 euro gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. e nuk cenon figurën e prokurorit dhe nuk ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia.

**93.** Komisioni arrin në konkluzionin se në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit subjekti i rivlerësimi ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimi të pasurisë.

#### **VLERËSIMI I FIGURËS**

**94.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimi, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimi ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/206, për subjektin e rivlerësimi, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimi, z. Edvin Kondili.

**95.** Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimi, ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

**96.** Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

## **Konkluzioni për kontrollin e figurës**

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit, z. Edvin Kondili, ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, **është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrë.**

## **VLERESIMI I AFTESIVE PROFESIONALE**

**97.** Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm.

**98.** Raporti për analizimin e aftësive profesionale kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë është hartuar bazuar në:

- 1) Formularin e vetëdeklarimit, të 3 (tre) dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) 5 (pesë) dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga 23 Prokuroritë e rretheve gjyqësore, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivit si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, i bazuar në gjetjet e këtij raporti, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet si më poshtë:

**Lidhur me aftësitë profesionale,** subjekti shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit.

Nga dosjet e vëzhguara, konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret. Kështu menjëherë pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit, përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon saktë, normën ligjore të zbatueshme.

**Lidhur me arsyetimin ligjor** evidentohet se subjekti i rivlerësimit Edvin Kondili shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtëshkrimore dhe etike. Tek aktet e përgatitura nga subjekti i rivlersimit, konstatohet se nga ana e tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.

**Lidhur me aftësitë organizative,** sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti në Formularin e Vetdeklarimit rezulton se për periudhën e punës si prokuror, subjekti ka trajtuar 81 çështje. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 12.12.2018 në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit Tetor 2013 - Tetor 2016, rezulton se nga ana e prokurorit Edvin Kondili tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara.

**Lidhur me aftësinë për të kryer procedurat hetimore/ gjyqësore,** subjekti i rivlerësimit Edvin Kondili kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese, u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat e aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve, konstatohet se në përgjithësi është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve. Gjithashtu vihet re se qëndrimi i prokurorit në seancë gjyqësore, është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

**Lidhur me aftësinë për të administruar dosjet,** prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara, janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit. Në dosjet për gjykim, fashikulli i prokurorit, konstatohet se ndodhen të administruara edhe lista e dëshmitarëve, konkluzionet me shkrim të paraqitura në gjykatë, si dhe apelet në rastet kur ka, duke e bërë qartësisht të lexueshme zgjidhjen e një çështje.

**Lidhur me etikën dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale,** ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nga ankesat e analizuar për subjektin, rezulton se nuk janë gjetur të dhëna që të tregojnë se nga ana e subjektit të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla, jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Në ankesat e paraqitura, shtetasi M.L., ka paraqitur pretendimet e tij kryesisht të lidhur me qëndrimin e tij ndaj vendimmarrjes së prokurorit dhe këto pretendime janë shqyrtuar nga organi përkatës, duke dalë me një përgjigje/vendim.

**Lidhur me integritetin,** konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me ndikimin e tij nga presionet e jashtme.

**Lidhur me paanësinë,** nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit prokurorit Edvin Kondili. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

**Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional**, në të 3 dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjet e rëna në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

**Lidhur me aftësinë për të bashkëpunuar**, në 2 dokumentet ligjore të dorëzuar nga subjekti konstatohen të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit prokurorit Edvin Kondili për të bashkëpunuar me kolegët pasi në të dy procedime penal subjekti ka qenë i ngarkuar për hetimin e tyre me grup prpkurorësh

**Lidhur me gadishmërinë për t'u angazhuar**, subjekti Edvin Kondili rezulton gjatë kohës së rivlerësimit dhe më parë ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

Nga verifikimi në arshivën e Prokurorisë së Përgjithshme rezulton që ndaj subjektit të rivlerësimit z. Edvin Kondili nuk është ka asnjë masë disiplinore në fuqi.

**99.** Komisioni, nuk gjeti asnjë indice apo elementë që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

#### **Konkluzioni për komponentin e vlerësimit profesional**

Lidhur me vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të vlerësimit, trupi gjykues bazuar në: (i) konstatimet e mësipërme; dhe (ii) pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se:

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit, është vlerësuar “i aftë” profesionalisht.

#### **DENONCIME**

**100.** Në Komision në lidhje me subjektin e rivlerësimit janë depozituar 3 denoncime.

1. Denoncim nga shtetasi M.H.L.
2. Denoncim nga shtetasi E.M.
3. Denoncim nga shtetasi A.E.

**101.** Pas shqyrtimit të tre denoncimeve të paraqitura në raport me elementët e pikave 1 dhe 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se “1. Çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit. Institucioni i rivlerësimit është i detyruar të kontrollojë nëse informacioni është dhënë nga një person i njohur ose anonim. 2. Informacioni duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore, sipas kriterëve të rivlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat ligjore, rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhënat mbi identitetin e personit”.

**102.** Nga Komisioni nuk u gjetën indice apo elementë që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale, për veprime apo elementë që cenojnë figurën e prokurorit



## **KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Edvin Kondili, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Edvin Kondili, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 07.06.2019.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Roland ILIA**  
Kryesues

**Valbona SANXHAKTARI**  
Anëtare

**Xhensila PINE**  
Relatore

*Sekretare gjyqësore*  
*Olsida Goxhaj*

